

## FJALA E GVERNATORIT

Ekonomia shqiptare ka bërë një progres të dukshëm gjatë vitit 2024.

*Inflacioni* u përgjysmua nga nivelet e një viti më parë, duke reduktuar kostot e jetesës dhe duke rritur vlerën e të ardhurave dhe të kursimeve të familjeve shqiptare. Përtej rënies së inflacionit në tregjet botërore, një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë dhe reagimi në kahun dhe në masën e duhur i politikës sonë monetare. Normalizimi i kujdesshëm i qëndrimit të politikës sonë monetare gjatë viteve 2002 – 2023, bëri të mundur reduktimin gradual të inflacionit, pa dëmtuar trendin pozitiv të rritjes ekonomike dhe shëndetin e bilanceve financiare të ekonomisë.

*Rritja ekonomike* mbeti në nivele të larta, duke gjeneruar rritje të punësimit e të pagave dhe më shumë të ardhura për familjet dhe bizneset shqiptare.

Po ashtu, *shëndeti ekonomik dhe financiar* i ekonomisë u përmirësua: borxhi i huaj dhe ai publik shënuan rënie, bilancet financiare të bizneseve dhe familjeve mbeten të shëndetshme, dhe treguesit e qëndrueshmërisë dhe të ndërmjetësimit të sektorit bankar u konsoliduan.

Në pasqyrim të këtyre trendeve pozitive, Shqipëria ka njohur një përmirësim të renditjes së borxhit publik të vendit nga agjencitë prestigjioze ndërkombëtare. Ky përmirësim, i pari në historinë post-tranzicion, do të na ndihmojë të ulim kostot e financimit të sektorit publik dhe privat në tregjet e huaja.

Megjithatë, goditjet nga mjedisi i jashtëm nuk munguan. Rënia e inflacionit ishte më e shpejtë se pritjet, e ndikuar nga rënia e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës dhe nga forcimi i vazhduar i Lekut. Në tremujorin e tretë, inflacioni zbriti në 2.0%. Në përgjithësi, goditje të tilla kanë një ndikim kalimtar në inflacion, nëse ato nuk prekin pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin në të ardhmen. Menaxhimi i këtyre pritjeve është një prioritet i politikës sonë monetare për momentin.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të këtij Raporti, ne vendosëm të lehtësojmë kushtet financiare në ekonomi në mbledhjen datës 6 nëntor. Në këtë mbledhje, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 2.75%. Kjo vendimmarrje ishte një hap i nevojshëm për kontrollin e inflacionit dhe për kthimin e tij në objektiv gjatë vitit të ardhshëm.

Parashikimet për të ardhmen janë pozitive.

Rritja solide e ekonomisë do të vijojë të ushqehet nga rritja e konsumit, investimeve dhe e eksporteve shqiptare, e në veçanti ato të turizmit. Po ashtu,



ajo do të vijojë të mbështetet nga gjendja e mirë financiare e sektorit privat dhe optimizmi i tij për të ardhmen, nga nivelet e ulëta të normave të interesit dhe rritja e kreditimit, si dhe nga interesimi i të huajve për të vizituar dhe investuar në vend. Kjo rritje do të shoqërohet me zgjerim të mëtejshëm të punësimit e të pagave, si dhe me rritje të mirëqenies së familjeve shqiptare. Nga ana tjetër, inflacioni parashikohet të luhatet pranë niveleve aktuale gjatë muajve të mbetur të vitit 2024 dhe të kthehet gradualisht në objektivin 3% gjatë gjysmës së parë të vitit të ardhshëm.

Kontributi më i mirë që Banka mund të japë për të mbështetur rritjen ekonomike dhe mirëqenien shoqërore është të garantojë një inflacion të ulët dhe të qëndrueshëm. Zhvillimet e fundit globale krijojnë pasiguri dhe rreziqe ndaj të ardhmes. Për këtë arsye, vendimet tona do të vazhdojnë të orientohen nga të dhënat e reja dhe do të balancojnë me kujdes rreziqet ndaj inflacionit dhe rritjes ekonomike, në afatin e shkurtër e të mesëm. Në çdo rast, vendimet do t'i shërbejnë arritjes e ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

